VENDIM
Nr.39, datë 10.6.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 4, DATË 16.9.2009 "PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE, BYROSË DHE PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 55 pika 1 dhe neneve 8 e 10 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr. 4, datë 16.9.2009 "Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve, byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit", bëhen këto shtesa:

I. Në fund të pikës II shtohen fjalët "dhe Namik Dokle".

II. Në pikën III, në përbërjen e Sekretariateve të Kuvendit bëhen këto shtesa:

1. Në Sekretariatin për Buxhetin e Kuvendit, deputeti Erion Braçe zgjidhet sekretar, ndërsa deputetja Mimi Kodheli zgjidhet anëtare.

2. Në Sekretariatin për Procedurat dhe Votimet, deputeti Armando Subashi zgjidhet anëtar.

3. Në Sekretariatin për Statusin e Deputetit, deputetja Ermonela Felaj zgjidhet anëtare.

4. Në Sekretariatin për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare, deputeti Fatmir Toçi zgjidhet anëtar.

5. Në Sekretariatin për Marrëdhëniet me Jashtë, deputeti Qemal Minxhozi zgjidhet anëtar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)